



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021, miratoi këtë

**V E N D I M**

- I.** MIRATOHET Vendimi për shfuqizimin e Rregullores për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese, nr. 01-011/01-82553/21, dt. 12.05.2021.
- II.** Sipas pikës I të këtij vendimi, shfuqizimi bëhet për shkak të vlerësimit negativ të ligjshmërisë së Rregullores nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).
- III.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-011/01-185467/21, më 03.09.2021**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

